

tjattrit, i thotë "tungiajeta;" edhe ay që e mer
përgjigjet "tungiajeta."

Për dasmë:

— Për hair të dasmit; Zoti t'a bafë për hair.

Përgjigja:

— Paç hair e nafak.

Për linkë:

— Me jetë të gjatë.

Përgjigja:

— Të lumtë goja.

Për vdekje:

— Zoti të dhasht kivet; kivet paç, ti shënnosh.

Përgjigjet janë:

— Faqe bardhë qoshi si keni ardhë me më
pâ; me gjith shoq shënnosh; me miq shënnosh.

Miq që dalin nga shtëpia e të vdekurit tho-
më dyke u ndarë:

— Mâ për të keq mos ardhçim.

Të tjerët përgjigjen:

— Krishni e pastë në parris.

Ditë kremte:

— Priç te mirin mot.

— Me gjith ju shënnosh.

Mirditasit bëjnë bë me këtë mënyrë:

Për qell e për dhë; për të madhin Zot; për
faqeten Zot; për atë zjarm; për at kryq Krishtit;
për atë keshë; për krye të djelmvet, etj.